

**BASHKIA BELSH  
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 31/ 07/ 2026

**PROCES – VERBAL  
“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 25.06.2026”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

**Janë prezent në mbledhje 16 këshilltarë:**

1. Kujtim Dervishi
2. Erjon Qafa
3. Nexhip Elezi
4. Aleksander Idrizi
5. Naime Ibrahim
6. Nertila Uruçi
7. Dorina Meta
8. Blerim Kuqja
9. Asqeri Kuqja
10. Avni Shtylla
11. Gazeli Hysa
12. Fadil Zdrava
13. Ismail Paja
14. Bujar Blloku
15. Gezim Gjoshi
16. Erion Gjoshi

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Propozon shtesë në rendin e ditës të një kërkesë për reformën territoriale nga qytetarët, si dhe një projekt vendim nga Dr.e Financës.
- Futet në rendin e ditës me 16 vota pro kërkesa e qytetarëve dhe me 9 vota pro dhe 7 kundër shtesa nr.2 për Tavanet e Buxhetit.
- Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 16 vota pro.
- Diskutohet pika nr.1: Kërkesa e qytetarëve në lidhje me reformën territoriale, ku Bashkia Belsh pritet ti Bashkohet Elbasanit në propozimin e qeverisë.
- Fillon diskutimi për Bashkinë dhe reformën territoriale.
- Ismail Paja: Nuk është marrë asnjë mendim nga qytetarët për shkrirjen e Bashkisë Belsh. Jam kundër Bashkimit me Elbasanin.

- Blerim Kuqja: Çfarë solli reforma e 2014? Shumë komunitete janë larg vendimarrjes. Nuk na duhen Bashkime por më shumë shërbime. E kundërshtoj këtë reformë sepse duhet konsultim më i gjërë.
- Erion Gjoshi: Nuk e kam shumë të qartë , dhe jam kundër që Bashkia Belsh ti bashkohet një bashkie tjetër.
- Nertila Uruçi: Shërbimet do të largohen më shumë nga qytetarët dhe jam shumë kundër kësaj reforme.
- Asqeri Kuqja: Është detyrë morale që ne të shprehemi.Heshtja do të ishte një fund i hidhur. Unë mendoj që qytetarët të shprehen bashkë me të zgjedhurit. Çfarë ka Peqini më shumë se ne? Deklarimin duhet ta bëjë i pari i institucionit. Ne si këshill duhet të shprehemi që nuk jemi dakord. Jam kundra kësaj reforme.
- Kujtim Dervishi: Mendoj që Këshilli Bashkiak do të shprehet në lidhje me këtë çështje në momentin e duhur.
- Kujtim Dervishi: Nuk jemi në momentin për një votim. Jemi pro iniciativës qytetare.
- Bujar Blloku: Jam pro kërkesës së qytetarëve. Do kërkoja një informacion nga Bashkia.
- N.Uruçi: Duhet të dalim në një deklaratë kundër bashkimit me Elbasanin.
- Diskuton Lodian Hasko si iniciator i kërkesës së qytetarëve dhe kundërshton shkrirjen e Bashkisë Belsh.
- Diskuton Edlir Dervishi me profesion mësues. Prezanton deklaratën e tij në lidhje me reformën territoriale.Rreshton disa problematika që ka Bashkia Belsh, problemi i pronësisë së tokës,problemi i një çerdheje,mungesa e investimeve në rrugët e arave etj.
- E.Dervishi: Duhet të mendojmë lokalisht për mirqënien e banorëve të Dumresë.Duhet të mbetemi Bashki më vete.
- Kujtim Dervishi: Këshilli Bashkiak do shprehet dhe do vazhdojmë me rendin e ditës.
- Kalojmë te 6% në pikën nr.1 të rendit të ditës.
- Kalon 6% me 16 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës për emërimin e anëtarëve të këshillit rinor. Prezanton Kristina Qosja.
- I.Paja : Jam kundra këtij këshilli.
- Blerim Kuqja: Jam dakord por kundra mënyrës së përzgjedhjes.
- N.Uruçi: Do të donim një informacion për anëtarët.
- Kalon KVR me 9 vota pro,6 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës.Mbron Ditjon Pepa projekt vendimin dhe Ana Musta.
- Blerim Kuqja: A janë realizuar shërbimet?
- D.Pepa : Zyra e të ardhurave ka tejkaluar planin.
- Hidhet në votim pika nr.3 dhe nuk miratohet me 9 vota pro dhe 6 kundër.
- Largohet këshilltari Asqeri Kuqja nga mbledhja.
- Kalojmë te pika nr.4 e rendit të ditës. Mbron Ana Musta me detyrë Pergjegjes Finance.
- Hidhet në votim dhe nuk miratohet me 9 vota pro,4 kundër dhe 2 abstenim.
- Kalojmë te projekt vendimi për miratimin e Tavanëve Perfundimntare për buxhetin 2027-2029. Hidhet në votim dhe nuk miratohet me 9 vota pro , 3 abstenim dhe 2 kundër.
- Kalojmë te pika nr.6:P/vendim për miratimin e palanit të mbarështimit Ekonomia Pyjore Dumre.Mbron Klodian Ganci P/vendimin.
- I.Paja: Sa hekarë janë?
- K.Ganci: Janëm mbi 800 hektarë pyje.



- Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro pika nr.6 e rendit të ditës.
- Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës. Mbron Klodian Ganci.
- B.Kuqja: A janë informuar banorët?
- K.Ganci: Linja ka kaluar dhe ka patur dhe shpronësime.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro dhe 1 kundër.
- Kalojmë te pika nr.8 e rendit të ditës për miratimin e planit lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Belsh.
- Mbron punonjësja e zyrës Sheje Ndoni.
- I.Paja: Jam kundra këtij p/vendimi.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 9 vota pro, 5 kundër dhe 1 abstenim plani i menaxhimit të mbetjeve.
- Kalojmë te pika nr.9 e rendit të ditës, "Plani i integritetit"
- Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro pika nr.9
- Kalojmë te të ndryshmet: Kërkesë për ndihmë financiare nga znj. Verushe Kurtesi.
- Duhet ndryshim në buxhet ,kështu që nuk mund të diskutohet kërkesa për ndihmë financiare.
- Kujtim Dervishi: Duhet të shprehim mbështetjen në lidhje me kërkesat e qytetarëve për mos shkrirjen e Bashkisë Belsh. Mendoj që shërbimet duhet të jenë më afër qytetarit. Duhet të shprehemi që jemi kundër aneksimit të Bashkisë Belsh në Elbasan.
- Blerim Kuqja: Me shkrirjen e komunave u çënuar shërbimi ndaj qytetarëve.
- Në parim të gjithë këshilltarët u shprehen në mbështetje të kërkesës.
- Mbyllet mbledhja me 6 vendime të miratuara.

**Përgatiti :**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Endri REPA**

